



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:145764

Datë: 05.01.2024

Numri i dokumentit: 05157740

Ep.nr.201/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Sh.A.(K), me seli në B “B.K”, nr.5, Ndërtesa e E....., kati ...I, P, , ndaj debitorit F. B. B. M, me adresë në rrugën “A”, p.nr. Komuna e P, me bazë juridike përmbarimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Z. B, me seli në Pejë, P.nr./I.br.192/22, i datës 23.06.2022, jashtë seancës gjyqësore, me datë 05.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR prapësimi i debitorit F. B. B M, me adresë në rrugën “A”, p.nr. komuna e P, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri i Përmbaruesit Privat Zija Bala, me seli në Pejë, P.nr./I.br.192/22, i datës 23.06.2022, sa i përket shumës së borxhit në lartësi prej 364.31 euro.

II.REFUZOHET I PABAZUAR pjesa tjetër e prapësimit të debitorit dhe MBETET NË FUQI Urdhri i Përmbaruesit Privat Z. B, me seli në Pejë, P.nr./I.br.192/22, i datës 23.06.2022, sa i përket shumës së borxhit në lartësi prej 273.47 euro.

A r s y e t i m

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me, Sh.A.(K), me seli në B “B.K”, nr.5, Ndërtesa e E....., kati ...I, P, me datë 21.06.2022, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për

pagesat e konsumit të energjisë elektrike për periudhën kohore nga data 29.11.2021 deri me datën 14.05.2022, baza juridike borxh në vlerë prej 637.78€.

Përmbartuesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, me Urdhrin për Përmbartim P.nr./I.br.192/22, i datës 23.06.2022, ka lejuar përmbartimin e propozuar.

Debitori me datën 01.07.2022, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbartimor, duke theksuar se gabimisht është ngarkuar me fatura ku vetëm në muajin mars 2022 jam ngarkuar me dy fatura dhe atë me datën 01.03.2022 vlera 29.92 euro ndërsa me datën e njëjtë 01.03.2022, jam ngarkuar edhe me 63.59 euro dhe pagesa për këtë periudhë kohore është 390 euro sipas faturave dhe pagesave të bëra dhe faturimi është 591.96 euro që do të duhej të minusohet fatura e datës 01.03.2022 prej 29.92 euro dhe shpenzimi do të binte 562.04 si dhe pagesat e bëra 390 euro dhe diferenca do të ishte vetëm 172.04 euro të cilën jam i gatshëm ta paguaj, duke i propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin përtej kësaj shume.

Përfaqësuesi i kreditorit me datën 06.07.2022, ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar dhe të paargumentuar përmes asnjë prove prapësimin e debitorit. Sa i përket pretendimeve të debitorit se janë shkelur dispozitat e neneve 75 dhe 76 të LPK-së, nuk qëndrojnë pasi që me provat e bashkangjitura është vërtetuar gjendja reale dhe e plotë faktike, duke shtuar se kërkesa për prapësim nuk është në harmoni me nenin 69 të LPP-së, dhe se prapësimi është bërë për të zvarritur procedurën, me propozimin dhe ta refuzoj prapësimin dhe urdhrin përmbartimor ta le në fuqi.

Gjykata në procedurën përmbartimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, përgjigjen në prapësim të dhënë nga pala kreditore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së urdhrin përmbartimor dhe dokumentit të besueshëm.

Në propozimin për përmbartim të datës 23.06.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Z B, me seli në P, me P.nr./I.br.192/22, i datës 23.06.2022, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat afariste, nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 29.11.2021 deri me datën 14.05.2022, në shumën prej 637.78 euro në emër të konsumit të energjisë elektrike.

Gjykata vlerëson se dokumenti i besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, mbi bazën e së cilës është filluar procedura përmbarimore, është dokumenti juridik i besueshëm dhe titull i përshtatshëm për përmbarim, dhe si i tillë plotëson të gjitha kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP-së), që përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Në këtë drejtim, dokumenti i besueshëm, mbi bazën e së cilës është aprovuar edhe urdhri për përmbarim është i ligjshëm dhe në harmoni me par.3 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se: *“Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata pas vlerësimit të dokumentit të besueshëm-ekstraktit dhe argumenteve të paraqitura nga debitori, gjen se prapësimi i debitorit për shfuqizim të urdhrin përmbarimor, është pjesërisht i bazuar.

Pas vlerësimit të ekstraktit afarist gjykata vlerëson se debitori për periudhën për të cilën është kërkuar borxhi nga data 29.11.2021 e deri me 14.05.2022, ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 593.47 euro, ndërsa që pagesa të bëra gjatë kësaj periudhe janë me datën 07.01.2022 pagesa në vlerë prej 100.00 euro, me datën 07.02.2022 pagesë me vlerë prej 100.00 euro, me datën 02.03.2022 pagesë me vlerë prej 70.00 euro dhe me datën 12.04.2022 pagesa me vlerë prej 50.00 euro, që në total janë 320.00 euro pagesa.

Duke marrë për bazë se detyrimi i debitorit për periudhën 29.11.2021 e deri më 14.05.2022 është 593.47 euro, dhe se debitori po në këtë periudhë kohore kishte bërë pagesa në shumë prej 320.00 euro, atëherë borxhi i mbetur ndaj kreditorit është shuma prej 273.47 euro. Gjykata deri tek ky konkludim ka ardhur duke zbatuar dispozitën ligjore nga neni 276 par.1 të LMD-së, që përcakton se: *“Detyrimi shuhet kur ai përmbushet si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj”*.

Për këtë pjesë të detyrimit, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitiv të aktvendimit, dhe debitori detyrohet që shumën prej 273.47 euro t’ia paguaj kreditorit.

Sa i përket pretendimit se i njëjti është faturuar dy herë përgjatë muajit mars, gjykata këto pretendime i vlerëson si jorelevante për vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore, poashtu edhe në jo përputhshmëri me kushtet që parashihen me nenin 71 të LPP-së, për shkaqet e prapësimit. Gjykata thekson se procedura përmbarimore nuk është iniciuar në bazë të faturave por në bazë të ekstraktit afarist, në bazë të të cilit debitori është përcaktuar si konsumator për furnizim me energji elektrike, në të cilin në mënyrë të detajuar janë të përcaktuara shuma e detyrimeve të debitorit, koha e arritjes së tyre dhe pagesat e bëra, të cilat e bëjnë të kërkueshme kredinë e kreditorit ashtu siç është elaboruar edhe më sipër tek shqyrtim i vlefshmërisë së urdhrin përmbarimor dhe dokumentit në bazë të cilit është lëshuar. Për më tepër, gjykata thekson se, procedura përmbarimore zbatohet në mbështetje të parimit rigoroz formal i cili është parim i veçantë i procedurës përmbarimore, sipas të cilit gjykata nuk ka tagër të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë materiale të vendimit apo të përmbajtjes së tij dhe të rregullsisë së dokumentit, por vetëm shqyrton elementet formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi si dhe përshtatshmërisë së vendimit që është objekt i përmbarimit, e assesi nuk shqyrton çështje tjera kontestuese.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *“gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par. 1 nënpar.2, nënpar.3 dhe par.3 lidhur me nenin 73 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:145764
Ep.nr.201/2022, me datë 05.01.2024.

G j y q t a r j a

Blerta KELMENDI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimet të aktvendimit, përmes
Gjykatës Themelore në Pejë.